



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.245/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP E... me seli në fshatin, Komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Kerveshi&Partners” Shpk me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.831/17 të datës 06.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit NTP E... me seli në fshatin, Komuna e Vushtrrisë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.831/17 të datës 06.02.2020, VËRTETOHET

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.831/17 të datës 06.02.2020, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP E... me seli në fshatin, Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës nr. 103/2017 i datës 11.04.2017, dhe të lirohet paditësi tërësisht nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit shtesë, mbi bazën e rritjes së çmimeve të shitjes me pakicë, si vlerësim i pa bazuar dhe i paligjshëm. Nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, mbetet në fuqi vendimi nr.103/2017 i datës 11.04.2017 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë. Ndërsa nën pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit “Kerveshi&Partners” Shpk me seli në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës material, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës nr.103/2017 i datës 11.04.2017 ose i njëjti aktgjykim të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Konstatimi i gjendjes faktike nga gjykata nuk është mbështetur me asnjë provë materiale, se paditësi ka shitur mallin lëndor konsumatorëve final me çmim më të lartë në krahasim me

çmimet e deklaruara dhe të regjistruara sipas çmimit faktitk, të ndodhur bazuar në kupon fiskal të shitjes që janë lëshuar konsumatorëve të fundit. Gjykata e shkallës së parë ka nxjerr vendim, nën zbatim të gabuar të drejtës materiale, pasi që nuk ka vlerësuar drejt dispozitat e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligjit 03/L-146 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-197 dhe Ligji 04/L-108 për TVSH. Gjykata ka dështuar ta arsyetoj veprimin për rritjen e çmimit të shitjeve me kupon konsumatorëve të fundit bazuar në informata të palëve të treta. Gjykata ka dështuar të argumentoj pretendimet e paditësit se çmimet krahasuese të bizneseve tjera kur është nxjerr çmimi mesatar krahasues i shitjes me pakicë a korrespondon në shkallën e njëjtë të tregut për furnizimin e mallrave në momentin kur është furnizuar paditësi, sepse shkalla e ndryshme e furnizimit përcakton kosto të ndryshme të çmimit të blerjes së mallit që ka refleksion direkt në çmime të ndryshme të tregut të mallit të njëjtë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar nr.103/2017 i datës 11.04.2017, të Administratës Tatimore të Kosovës - Departamenti i Ankesave, nën pikën I të dispozitivit të vendimit është refuzuar ankesa nr.103/2017 I datës 15.03.2017 e subjektit NTP "E..." me NRF ..., me pronar E.C., me seli të biznesit në fshatin-Vushtrri, në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit Nr. 02/L-28 "Për Procedurën Administrative" në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat". Nën pikën II të dispozitivit të vendimit, procedura e ankesës nuk ndërprente sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës Administratës Tatimore të Kosovës–Departamenti i Ankesave, me padinë e ushtruar në gjykatë ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr.103/2017 dt.11.04.2017, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.103/2017 i datës 11.04.2017, të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor dt.06.02.2020, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën Kërkesëpadinë e paditësit, e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur të paditurës. Me arsyetim se e paditura, aplikimin e vlerës së hapur të tregut për paditësin e ka bërë si rezultat i asaj, që paditësi nuk i ka prezantuar kontrollit librat dhe regjistrimet e biznesit siç e ka pasur obligim konform nenit 13 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, në mungesë të librave të blerjes dhe shitjes për periudhën e kontrollit, në mungesë të faturave të shitjes për disa periudha tatimore, në mungesë të librave të stoqeve, në mungesë të librit të arkës, dhe faktit se paditësi ka prezantuar disa bllok paragon, me të drejtë e paditura ka aplikuar vlerën e hapur të tregut sipas nenit 19.2 të Ligjit 03/L-222 dhe nenit 24 të Ligjit 03/L-146 për TVSH. Nga aktiviteti i inspektorit tatimor tek palët e treta, vërehet se çmimi i blerjes i gjedheve për kg në territorin e Komunës së Vushtrrisë është sjell nga 1.40€/kg deri 2.20€/kg, e në bazë të

këtyre informative ka rezultuar qarkullimi dhe tatimi shtesë sipas Njoftim rivlerësimeve për tatimin shtesë. Gjykata konsaton se paditësi në konflikt administrativ ka dështuar që të prezantoj provat me të cilat do të mbështeste pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse, që të prezantoj para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij siç parashihet me nenin 81F dhe 81E par.4 dhe 5 të Ligjit 04/L-102.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të drejtës materiale dhe as me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikim të gabuar të dispozitave materiale, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa ai përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka nxjerr vendim nën zbatim të gabuar të drejtës materiale, pasi që nuk ka vlerësuar drejt dispozitat e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligjit 03/L-146 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 03/L-197 dhe Ligji 04/L-108 për TVSH, ky Kolegj nuk i aprovoj, sepse vlerësoj se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, me të drejtë ka konstatuar se me kontroll janë gjetur parregullsi në regjistrimin dhe deklarimin e qarkullimit, respektivisht qarkullimi dhe tatimi shtesë për paditësin ka rezultuar për shkak se i njëjti nuk ka prezantuar regjistrimet e biznesit, librat e blerjes dhe shitjes, faturave të shitjes për periudhën tatimore, librin e arkës, veprime këto që parashihen me dispozitën e nenit 13 të Ligjit 03/L-202 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Paditësi as në ankesë nuk i kundërshton këto fakte se ka paraqit para kontrollit regjistrimet dhe librat e shitjes apo pagesë të faturave për të dëshmuar deklarimin e shitjeve për periudhën e kontrollit 2010-2013 për TVSH dhe TAP.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë konfirmon vendimit e të paditurës të nxjerr në procedurën administrative të ankesave, ku vlerësimi i kontrollit tatimor, në mungesë të posedimit të librave dhe regjistrimeve, ka bërë verifikimin e gjendjes faktike duke siguruar provat dhe informatat nga palët e treta, të konstatuara në Shënimet e aktivitetit të inspektorit që gjenden në lëndë, dhe çmimet e rivlerësuara nga çmimet e shitjes nga bizneset tjera që bëjnë shitje për klient të fundit, është nxjerr mesatarja e çmimeve të shitjeve për mallin gjedhe të gjalla, nga kontrolli. Gjithashtu Kolegji vlerësoi, se me të drejtë e paditura ka vërtetuar gjendjen faktike duke u referuar në çmimet e shitjes së mallrave të njëjta duke aplikuar vlerën e hapur të tregut në mbështetje të nenit 24 par.2 të Ligjit 03/L-146 për TVSH, që parasheh se: “Për nevoja të këtij Ligji “Vlera e hapur e tregut” nënkupton shumën e plotë që duhet të paguaj konsumatori në shkallë të njëjtë të tregut në të cilën ndodh furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, nën kushtet

e konkurrencës së barabartë, për furnizuesin nën mbizotërimin e tregut brenda Kosovës ku është bërë furnizimi, në mënyrë që të marr mallrat ose shërbimet në fjalë në atë moment”.

Pra, paditësi as në procedurë administrative tek e paditura, por as para gjykatës nuk ka arritur që të paraqes dëshmi konkrete dhe prova të besueshme se ka mbajtur librat dhe regjistrimet e biznesit konform legjislacionit tatimor të aplikueshëm, nuk ka regjistruar faturat e shitjes, librat e shitjes sipas ligjit, dhe nuk ka regjistruar të gjitha hyrjet dhe daljet e biznesit në arkë, siç përcaktohet në nenin 17 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2020 për zbatimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se vlerësimi i ATK-së, është bazuar në provat në dispozicion dhe dispozitat ligjore të aplikueshme, përkatësisht neni 19.2 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Prandaj, sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.245/22 datë 10.11.2020

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha